



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 16 maj 2019, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Piro	MISHA	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar
Zylyftar	BREGU	Anëtar

Bordi i AMA-s diskutoi mbi reagimet ndaj rubrikës “Be Coffee”, të emisionit “E diela Shqiptare, të transmetuar në televizionin kombëtar “Klan”, më datë 03.02.2019, mbi figurën e dëshmorit Mujo Ulqinaku. Në fund të diskutimeve, AMA ra dakord që operatorit t’i tërhiqet vëmendja për të pasur në konsideratë shmangien e situatave të papërshtatshme dhe që zbehin apo nënvlerësojnë rolin, kontributin dhe nderimin e figurave historike kombëtare. AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Rinovimin e licencës së shoqërisë “Loudcom Media” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Energy”. **(Vendimi nr. 77 datë 16.05.2019)**
2. “Rinovimin e licencës së shoqërisë “Media Kontakt” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Kontakt”. **(Vendimi nr. 78 datë 16.05.2019)**
3. “Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “ABcom” sh.p.k., autorizuar për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv privat mbështetur në rrjet kabllor “ABCom” dhe ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “3N1 Tv”, në “Qarkun Fier”. **(Vendimi nr. 79 datë 16.05.2019)**
4. “Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Sky Elbasan” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Sky Elbasan”. **(Vendimi nr. 80 datë 16.05.2019)**
5. “Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit lëshuar për shoqërinë “Cable Net” sh.p.k., e autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Cable Net”. **(Vendimi nr. 81 datë 16.05.2019)**
6. “Pranimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik z. Ylli Xhafa dhe shfuqizimin e vendimit për dënimin me gjobë nr. 5, datë 15.04.2019, në masën 5,000,000 lekë të vendosur nga inspektorët e AMA-s, për ofrimin e shërbimit audioviziv pa autorizimin e AMA-s.” **(Vendimi nr. 82 datë 16.05.2019)**

7. “Rrëzimin e ankimit administrativ të subjektit person fizik Gentian Osmani dhe lënien në fuqi të vendimit për dënimin me gjobë nr. 2, datë 11.04.2019, në masën 5,000,000 lekë, të shoqërisë “G-Net” sh.p.k., vendosur nga inspektorët e AMA-s, për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në internet IPTV/OTT, pa autorizim nga AMA”.
(Vendimi nr. 83 datë 16.05.2019)

Tiranë, 16 maj 2019

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE